

REVISTA JURIDIKE SHQIPTARE

Marrëveshja Itali-Shqipëri: Një
paradigmë e re në menaxhimin e
migracionit dhe sfidat në garantimin e
të drejtave të njeriut

Renis META



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PUBLIKUES

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

Rr. Milto Tutulani, Nd.1, Ap. 3.

Tel: +355 44 104 247

E-mail: info@em-al.orgWeb: www.em-al.org**AUTORË**

Renis META

VITI I PUBLIKIMIT

mars 2026

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri, Revistës Juridike Shqiptare dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Hyrje	03
Modeli Italo-Shqiptar: Përmbajtja dhe pikat kryesore të marrëveshjes	04
Implikimet juridike të marrëveshjes	05
Marrëveshja nën perspektivën e Bashkimit Europian	07
Sfidat kryesore në garantimin e të drejtave të njeriut	08
Përfundime	10
REFERENCA	11

Shqipëria ka një histori të gjatë me lidhje të veçanta historike, kulturore dhe ekonomike me Italinë, duke qenë një nga destinacionet kryesore të emigrantëve shqiptarë prej tre dekadash (IOM, 2023).¹ Si rrjedhojë e flukseve migratore, kryesisht nga Shqipëria, për herë të parë në Itali u themeluan Centri di Accoglienza (Qendrat e pritjes), nëpërmjet Ligjit nr. 563/1995, të njohur si "Ligji i Pulias" (neni 2), ku u bë e mundur hapja e tre qendrave të pritjes në bregdetin e Pulias për të menaxhuar mbërritjet masive të njerëzve që kalonin Detin Adriatik, kryesisht të emigrantëve nga Shqipëria (Chaloff, 2008, fq. 5).² Tanimë pas më shumë se tre dekadash marrëdhëniet migratore duken se kanë marrë një tjetër formë përmes firmosjes së Protokollit ndërmjet qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për forcimin e bashkëpunimit në fushën e menaxhimit të migracionit të parregullt.

Në nëntor të vitit 2023, Shqipëria dhe Italia nënshkruan protokollin dypalësh në fushën e migracionit të konkretizuar përmes Ligjit nr. 14/2024, me objekt ndihmën reciproke për përballimin e flukseve të shtetasve të huaj që hyjnë në mënyrë të parregullt në territorin italian. Ky protokoll është një formë e re bashkëpunimi ndërmjet një vendi anëtar të BE-së dhe një vendi jo-anëtar, në përpjekje për të përballuar sfidat në rritje të migrimit (Camera dei Deputati, 2023).³ Kjo marrëveshje dypalëshe bazohet në Traktatin dypalësh të miqësisë dhe bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, të nënshkruar në Romë më 13 tetor 1995 dhe të ratifikuar me Ligjin nr. 170/1998⁴, si dhe në Protokollin e bashkëpunimit të

Ministrive të Brendshme të Italisë dhe Shqipërisë për forcimin e bashkëpunimit në luftën kundër terrorizmit dhe trafikimit të qenieve njerëzore, të nënshkruar në Tiranë më 3 nëntor të vitit 2017 (Këshilli i Ministrave, 2023).⁵

Italia, përballë sfidave të vazhdueshme të menaxhimit të flukseve migratore, ka ndjekur ndër vite një sërë mekanizmesh bashkëpunimi dhe "ndarjeje përgjegjësish" brenda kuadrit politik e legjislativ të Bashkimit Europian. Gjatë periudhës 2015–2018, Italia përfitoi mbështetje nga Bashkimi Europian përmes programeve emergjente të zhvendosjes, nëpërmjet të cilave mbi 34 000 migrantë u transferuan nga Italia dhe Greqia në shtete të tjera anëtare të BE-së (Këshilli i Bashkimit Europian, 2015).⁶ Më tej, Deklarata e Maltës e vitit 2019 krijoi një mekanizëm të përkohshëm për zhvendosjen e personave të shpëtuar në Mesdhe, duke mundësuar transferimin e rreth 3 000 individëve nga Italia dhe Malta në vende të tjera europiane (Këshilli i Bashkimit Europian, 2017).⁷ Këto përpjekje tregojnë se marrëveshja ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë më 6 nëntor 2023 është një zgjerim i mëtejshëm i qasjes së Italisë për menaxhimin e migracionit, duke u zhvendosur drejt partneriteteve me vende të treta jashtë BE-së.

Modeli Italo-Shqiptar: Përmbajtja dhe pikat kryesore të marrëveshjes

Protokolli i bashkëpunimit ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë për menaxhimin e migracionit, synon forcimin e bashkëpunimit dypalësh për menaxhimin e flukseve migratore nga vendet e treta, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe atë europiane (neni 2). Në thelb, protokollin ka për qëllim ndërtimin e një mekanizmi operacional për menaxhimin e migracionit të parregullt, duke përfshirë ngritjen e dy qendrave pritëse për migrantët në portin e Shëngjinit dhe në zonën e Gjadrit, në veri të Shqipërisë. Sipas dispozitave të protokollit, pala shqiptare i njej palës italiane të drejtën e përdorimit të këtyre zonave pa detyrim kompensimi për gjithë periudhën e vlefshmërisë së protokollit (neni 3). Këto qendra janë nën juridiksionin italian dhe financohen nga qeveria Italiane, ndërsa Shqipëria mundëson sigurinë e jashtme.

Këto struktura janë të destinuara për strehimin e shtetasve të huaj që nuk kanë të drejtë hyrjeje apo qëndrimi në territorin italian, ndërsa menaxhimi i tyre do të kryhet nga autoritetet italiane në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë të Bashkimit Europian. Në rast të ndonjë kontestimi apo mosmarrëveshjeje që mund të lind midis migrantëve të strehuar dhe autoriteteve përkatëse, çështjet do të trajtohen tërësisht nga juridiksioni italian, siç parashikohet në nenin 4, pika 2 e protokollit.

Protokolli synon të përshpejtojë procedurat për verifikimin e identitetit, shqyrtimin e kërkesave për mbrojtje ndërkombëtare dhe, kur është e mundur, riatdhesimin e migrantëve në vendet e origjinës. Gjithashtu parashikon ndihmë për Shqipërinë në forcimin e kapaciteteve të saj për menaxhimin e kufijve dhe procedurat e azilit.

Referuar dispozitave të protokollit, marrëveshja është parashikuar të mbetet në fuqi për një periudhë fillestare prej pesë vjetësh, me mundësi rinovimi automatik për një tjetër periudhë pesëvjeçare, në mungesë të një njoftimi të kundërt nga palët (neni 13, pika 2).

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i protokollit lidhet me transferimin në Shqipëri të migrantëve që ndodhen tashmë në territorin italian dhe ndaj të cilëve janë lëshuar urdhra dëbimi (provvedimenti di espulsione) apo masa ndalimi (provvedimenti di trattenimento), të konfirmuara ose të zgjatura në kuadër të vendimeve ekzistuese për rikthim.

Këta individë mund të zhvendosen dhe të mbahen në Qendrën për Rikthimin e Migrantëve (CPR) në Gjadër, siç parashikohet në Dekret-Ligjin nr. 37, datë 28 mars 2025 ("Disposizioni urgenti per il contrasto dell'immigrazione irregolare"), i miratuar nga Këshilli i Ministrave italian.⁸ Ky akt normativ konsolidon masat urgjente për frenimin e migracionit të parregullt dhe përfshin gjithashtu relacionin vjetor mbi listën e vendeve të sigurta, duke konfirmuar përmbajtjen e Dekret-Ligjit nr. 158/2024 ("Decreto-Legge 4 ottobre 2024, n. 158").

Kjo marrëveshje përfaqëson një praktikë të re dhe të pazakontë në nivel evropian, duke u diferencuar nga modelet ekzistuese të menaxhimit të migracionit si marrëveshja BE-Turqi ose nisma e dështuar e Mbretërisë së Bashkuar për të dërguar migrantë në Ruandë (Pettrachin & Bassoli, 2025).⁹ Ndryshe nga këto raste, ku shteti dërgues delegon përgjegjësinë për trajtimin e kërkesave për azil dhe mbajtjen e migrantëve te një shtet i tretë, modeli i bashkëpunimit Italo-Shqiptar nuk përfshin transferimin e përgjegjësisë juridike. Përkundrazi, juridiksioni mbi migrantët mbetet në duart e autoriteteve italiane, duke ruajtur kështu kontrollin ligjor dhe administrativ të plotë mbi proceset që zhvillohen në territorin shqiptar.

Implikimet juridike të marrëveshjes

Zbatimi i Protokollit dypalësh ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë mbi menaxhimin e flukseve migratore është përballur me sfida të mëdha ligjore në planin kushtetues dhe ndërkombëtar, duke e kufizuar zbatimin e plotë të marrëveshjes. Fillimisht, marrëveshja iu referua Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë për shqyrtim ex ante. Gjykata Kushtetuese në mbledhjen e datës 29 janar 2024, shqyrtoi kërkesën e 30 deputetëve të parlamentit shqiptar për të pezulluar procedurat e ratifikimit të “Protokollit për Migracionin” mes Shqipërisë dhe Italisë. Kërkesa synonte të verifikonte pajtueshmërinë e marrëveshjes me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë që garantojnë sovranitetin

shtetëror, juridiksionin territorial dhe të drejtat themelore të individëve që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë.¹⁰ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë më 29 janar 2024 e hapi rrugën për zbatimin formal të protokollit, Gjykata la të hapur çështjen e përgjegjësisë së shtetit shqiptar në rast të shkeljes së të drejtave të migrantëve, duke nxitur nevojën për një mekanizëm të qartë të mbikëqyrjes administrative dhe gjyqësore (Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, 2024).¹¹

Me fillimin e zbatimit praktik të marrëveshjes, autoritetet italiane realizuan transferimin e parë të migrantëve me origjinë nga Egjipti dhe Bangladeshi në strukturat në Shqipëri ku katër individë u kthyen në Itali pas vlerësimit të gjendjes së tyre të vulnerabilitetit (Tarabusi, 2024).¹² Kjo ngjarje nxiti shqetësime serioze në nivel ndërkombëtar për mungesën e garancive procedurale, aksesit në ndihmë juridike dhe mbikëqyrjes efektive të kushteve të ndalimit. Pas transferimit të parë Gjykata e Apelit në Romë vendosi që dërgimi në Shqipëri ishte i paligjshëm dhe riatdhësimi i tyre në vendet e origjinës shkelte ligjin ndërkombëtar të mbrojtjes (Tribunale Ordinario di Roma, Sezione Immigrazione, 2024).¹³ Gjykata e Romës, në vendimin e saj, i referohet çështjes C-406/22 të Gjykatës së Drejtësisë të BE-së (GJDBE), e ngjashme në disa aspekte me implikimet e kësaj marrëveshjeje (Court of Justice of the European Union, 2024)¹⁴, e cila përcakton detyrimin e instancave kombëtare për të vlerësuar kushtet konkrete që justifikojnë shpalljen e një vendi si “i sigurt”. Duke u mbështetur në të dhënat zyrtare të Ministrisë së

Jashtme italiane, gjykata vlerëson se si për Egjiptin ashtu edhe për Bangladeshin ekzistojnë shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut ndaj grupeve të caktuara (si opozitarët, aktivistët, komuniteti LGBTQ+, viktimat e dhunës gjinore, minoritetet, etj.), duke e bërë të papërshtatshëm përdorimin e procedurave të përsheptuara për këta persona (Corte d'Appello di Roma, 2025).¹⁵

Dy grupe të tjera me imigrantë pasuan të parin, një grup prej 8 vetësh mbërriti në brigjet shqiptare në 8 nëntor 2024 dhe i treti mbërriti në 28 janar të 2025 dhe në bord pati 49 imigrantë. Gjykata e Apelit në Romë pezulloi vendimmarrjen dhe vendosi se imigrantët nuk mund të qëndronin në Shqipëri (Tribunale di Roma, Ordinanza rinvio pregiudiziale, 11.11.2024).¹⁶ Çështja u referua në Gjykatën Europiane të Drejtësisë nëse vendet e origjinës së këtyre imigrantëve konsideroheshin të sigurt për riatdhesimin e tyre. Gjyqtarët italianë kërkuar nga Gjykata të sqaronte nëse mund të bëheshin përjashtime nga përkufizimi i vendit të sigurt për kategori të caktuara njerëzish.

Më 30 dhjetor 2024, Gjykata Italiane e Kasacionit, në vend që të merrte një vendim përfundimtar mbi çështjet e ndalimeve të migrantëve në kuadër të protokollit Itali-Shqipëri, miratoi një urdhër jo përfundimtar, me anë të së cilës pezulloi shqyrtimin gjyqësor deri në marrjen e një përgjigjeje nga GJDBE, e cila pritet të shprehet mbi çështjet e ngritura nga gjykatat italiane në lidhje me përcaktimin e “vendeve të sigurt të origjinës”.

Gjykata e Kasacionit në Itali i ka drejtuar dy kërkesa paraprake GJDBE-së, me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së protokollit dypalësh ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë me direktivat e Bashkimit Europian që rregullojnë kthimin dhe pritjen e shtetasve të vendeve të treta. Gjykata ka kërkuar interpretimin e nenit 3 të Direktivës për Kthimin 2008/115/KE, që përcakton kuadrin ligjor për kthimin e detyruar të migrantëve në mënyrë të rregullt dhe të respektueshme ndaj të drejtave themelore të njeriut. Çështja ka të bëjë me transferimin e një shtetasi të huaj, në gjendje “parregullsie administrative”, drejt Shqipërisë, në bazë të nenit 3, pika 2, të Ligjit nr. 14/2024. Gjykata kërkon të qartësohet nëse një transferim i tillë është në përputhje me kuptimin dhe qëllimin e kësaj direktive.

Në çështjen e dytë, Gjykata e Kasacionit ka kërkuar shqyrtimin e konformitetit të marrëveshjes me Direktivën për Procedurat e Azilit (2013/32/BE). Në këtë rast, Gjykata ngre dyshime mbi përputhshmërinë e dispozitave të legjislacionit italian me Direktivën 2013/32/BE, e cila rregullon procedurat për shqyrtimin e kërkesave për azil. Konkretisht, vihet në pikëpyetje ligjshmëria e mbajtjes së kërkuesve të azilit në struktura të huaja, bazuar mbi supozimin se kërkesa për azil është e “instrumentalizuar”, pra e përdorur thjesht për të vonuar ose shmangur largimin nga territori. Gjykata kërkon të sqarojë nëse një praktikë e tillë bie në kundërshtim me të drejtën e Bashkimit Europian.

Marrëveshja nën perspektivën e Bashkimit European

Një nga aspektet më të diskutueshme të marrëveshjes ndërmjet dy vendeve lidhet me procesin hermetik dhe mospërfshirjen e palëve të treta në diskutime. Protokollin ndërmjet dy vendeve është negociuar dhe miratuar pa përfshirjen direkte të institucioneve të Bashkimit European, apo agjencive të rëndësishme si Frontex dhe Agjencia Europiane për Azil (EUAA) (Carrera, Campesi & Colombi, 2023). Për më tepër, fillimisht marrëveshja është zhvilluar në mënyrë të mbyllur, pa përfshirjen e aktorëve të tjerë ndërkombëtarë me rol kyç në çështjet e migracionit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si UNHCR apo IOM (UNHCR, 2023).¹⁷ Megjithatë, pavarësisht procesit të mbyllur dhe të kufizuar në nivel përfaqësimi institucional, neni 9.2 i Protokollit parashikon që autoritetet italiane dhe shqiptare do të garantojnë akses në qendrat e pritjes për përfaqësuesit ligjorë, ndihmësit e tyre, si dhe për organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë e Bashkimit European që ofrojnë mbështetje dhe këshillim për kërkuesit e azilit, në përputhje me afatet dhe kufizimet e përcaktuara nga legjislacioni shqiptar, italian dhe european.

Një nga aspektet më të debatueshme të marrëveshjes qëndron në faktin se ai trajton çështje që bien qartë brenda kuadrit ligjor të Bashkimit European, por pa u përputhur plotësisht me Traktatet ekzistuese të BE-së, legjislacionin dytësor, si dhe me standardet

ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të detit (Carrera, Campesi & Colombi, 2023).¹⁸ Në këtë kuptim, “Modeli Itali-Shqipëri” përfaqëson një formë të ndryshme të zhvendosjes së procedurave kufitare të BE-së përtej territorit të saj, duke kufizuar hyrjen fizike në territorin italian dhe duke zhvilluar procedura azili në një vend të tretë, pa mundësuar hyrjen formale të migrantëve në territorin pritës, pra atë italian (De Leo & Celoria, 2025, f. 603).¹⁹

Procedurat e parashikuara në Protokollin Itali-Shqipëri dhe në ligjin për ratifikimin përfshijnë aspekte që bien në mënyrë të drejtpërdrejtë nën kompetencat e së drejtës së BE-së, sidomos në fushën e azilit dhe mbrojtjes ndërkombëtare. Megjithatë, autoritetet italiane kanë deklaruar se ligjet dhe juridiksioni italian do të zbatohen edhe në territorin shqiptar, vetë ligji i ratifikimit nuk e qartëson, nëse dhe si mund të zbatohet legjislacioni i BE-së jashtë kufijve të saj. Kjo paqartësi lë të hapur tensionin mes kufizimeve territoriale të direktivave të BE-së dhe pretendimit për zbatimin e tyre jashtë territorit, në këtë rast në Shqipëri. Arsyetimi i qeverisë italiane mbështetet në një interpretim të gjerë të konceptit të “kufirit”, duke e zgjeruar atë përtej territorit kombëtar në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i Protokollit pa nevojën për një kuadër të ri ligjor. Ndonëse, kjo qasje mund të jetë në kundërshtim me rregulloret ekzistuese dhe në zhvillim të BE-së për azilin, të cilat në përgjithësi nuk lejojnë përpunimin jashtë territorit (De Leo, 2023).²⁰

Referuar Amnesty International (2024)²¹, kjo marrëveshje cenon detyrimet ndërkombëtare të Italisë, si dhe parimet themelore të së drejtës

së BE-së dhe të Kushtetutës italiane. Kjo marrëveshje ngre shqetësime serioze në lidhje me përputhshmërinë ligjore dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të migrantëve, por edhe si një precedent potencial për marrëveshje të ngjashme në të ardhmen.

Përballë këtyre sfidave ligjore dhe tensioneve territoriale të ngritura nga marrëveshja, është me rëndësi të shqyrtohet edhe reagimi institucional i Bashkimit European ndaj këtij modeli bashkëpunimi ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë.

Në mënyrë indirekte, Bashkimi European e ka njohur marrëveshjen dypalëshe për menaxhimin e migracionit midis Italisë dhe Shqipërisë, duke theksuar se ajo duhet të zbatohet në përputhje të plotë me të drejtën europiane dhe ndërkombëtare. Në “Raportin e KE për Shqipërinë 2024”, Komisioni European nënvizon se protokollin e nënshkruar në nëntor 2023 duhet të implementohet duke respektuar standardet ligjore të BE-së dhe detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e azilkërkesve. Po ashtu, Komisioni nënvizon se kuadri ligjor shqiptar për azilin është në përputhje të gjerë me *acquis* të BE-së, por thekson nevojën për përmirësime praktike në funksionimin e sistemit të azilit (Komisioni European, 2024, fq. 47).²²

Megjithatë, vlerësimet kritike nuk kanë munguar. Sipas Varvelli dhe Ziccardi (2025)²³, mbështetja e BE-së për këtë model krijon një precedent të rrezikshëm që mund të nxisë një qasje të fragmentuar nga shtetet anëtare në trajtimin e çështjeve të migracionit.

Mbështetja e marrëveshjeve bilaterale ad hoc, si kjo ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë, mund të minojë përpjekjet për një qasje të unifikuar europiane deri në zbatimin e Paktit të ri European për Migracionin dhe Azilin të parashikuar për vitin 2026.

Në të njëjtën linjë, Parlamenti European ka zhvilluar diskutime mbi përputhshmërinë ligjore të kësaj marrëveshjeje me të drejtën e BE-së, me fokus të veçantë mbi ndikimin e saj në të drejtat e azilkërkesve. Këto diskutime kanë ngritur pikëpyetje mbi aspektet e marrëveshjes që sfidojnë ligjshmërinë e transferimit të migrantëve në vende jo-anëtare të BE-së përmes kësaj marrëveshjeje, duke vënë në pikëpyetje koherencën e saj me kornizën juridike europiane dhe parimet e solidaritetit dhe përgjegjësisë së përbashkët (Parlamenti European, 2024).²⁴

Sfidat kryesore në garantimin e të drejtave të njeriut

Marrëveshja ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë ka ngritur pikëpyetje të shumta, veçanërisht në lidhje me shkeljet e mundshme të të drejtave të njeriut dhe sfidat që ajo mbart për grupet vulnerabël. Amnesty International (2017)²⁵ ka qenë kritike ndaj qasjes së eksternalizimit të migracionit, duke e cilësuar atë si të papranueshme dhe, në disa raste, të paligjshme. Për më tepër, masat e propozuara në kuadër të politikave të tilla rrezikojnë të minojnë mbrojtjen dhe sigurinë e migrantëve dhe refugjatëve.

Kjo marrëveshje për transferimin e procedurave të azilit jashtë territorit pasqyron një prirje globale që tanimë është e dukshme në praktikën e ndjekura nga SHBA, Australia dhe Mbretëria e Bashkuar. Qasja në fjalë synon menaxhimin e migracionit përtej kufijve kombëtarë, por ngre shqetësime serioze për pasojat e saj mbi të drejtat e njeriut. Raste të ngjashme në vende të treta si Nauru, Manus apo Libia janë dokumentuar nga Amnesty International si përvoja me pasojat të rënda për mbrojtjen dhe mirëqenien e azilkërkuesve (Amnesty International, 2016, 2018, siç citohet në Amnesty International, 2024).²⁶ Marrëveshja krijon pasiguri të konsiderueshme ligjore në nivel ndërkombëtar, duke ngritur pikëpyetje serioze lidhur me përputhshmërinë e saj me të drejtën europiane dhe ndërkombëtare (Broerse, 2024).²⁷ Në mënyrë të veçantë, shqetësimet kanë të bëjnë me cenimin e drejtësisë procedurale, përfshirë qasjen në ndihmë juridike dhe të drejtën për një mbrojtje efektive gjyqësore (De Leo, 2023).²⁸

Amnesty International (2024) ka theksuar gjithashtu mungesën e qartësisë mbi mënyrën se si do të garantohen të drejtat e individëve të transferuar në një vend të tretë, përfshirë mbrojtjen nga diskriminimi dhe nga rreziqet e tjera që lidhen me shkeljen e të drejtave të njeriut (f.6, 9).²⁹

E veçanërisht shqetësuese është mungesa e garancive për identifikimin dhe trajtimin e grupeve vulnerabël, si fëmijët, gratë shtatzëna, personat LGBTQ+, refugjatët politikë, viktimat e trafikimit, si dhe personat me nevoja të veçanta mjekësore ose psikosociale (Varvelli

dhe Ziccardi, 2025).³⁰ Për më tepër, mbetet e paqartë nëse procesi i vlerësimit do të ndodhë në bord të anijeve apo pas zbakimit në territorin shqiptar, duke shtuar pasigurinë lidhur me mbrojtjen efektive të këtyre individëve (De Leo & Celoria, 2025, fq. 601).³¹

Komisioneri për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Europës (Council of Europe Commissioner for Human Rights, 2024)³² ka shprehur shqetësime të thella për respektimin e të drejtave të njeriut në kontekstin e kësaj marrëveshjeje, duke theksuar ndikimin potencialisht negativ që kjo praktikë mund të ketë mbi të drejtat e refugjatëve, azilkërkuesve dhe migrantëve në përgjithësi. Sipas të drejtës ndërkombëtare të refugjatëve, përgjegjësia parësore për shqyrtimin e kërkesave për azil i takon shtetit në të cilin refugjati mbërrin. Transferimi i kërkesës në një vend të tretë mund të lejohet vetëm nëse ky vend garanton respektimin e plotë të të drejtave të njeriut, të Konventës për Statusin e Refugjatëve, si dhe një ndarje të drejtë të përgjegjësisë ndërmjet shteteve (UNHCR, 2023).³³

As Protokollin dhe as ligjin e ratifikuar nuk parashikojnë një mekanizëm të qartë për vlerësimin e cenueshmërisë. Paragrafi 6 i ligjit të ratifikuar përmend vetëm se, “në raste të jashtëzakonshme”, një shtetas i huaj që ndodhet në zonat e përcaktuara mund të transferohet në struktura të ndodhura në territorin Italian, por pa sqaruar kriteret apo rastet konkrete që përbëjnë një situatë të tillë. Zbatimi i mëtejshëm i kësaj marrëveshjeje mund të krijojë një mjedis të rrezikshëm për migrantët e parregullt që synojnë të hyjnë në territorin italian, duke i ekspozuar ata ndaj trafikimit dhe shfrytëzimit, dhe duke i vendosur në një situatë të vulnerabilitetit (Giordani, 2024, fq. 12).³⁴

Marrëveshja dypalëshe mes Italisë dhe Shqipërisë për menaxhimin e migracionit ka prodhuar një sërë implikimesh të ndërlikuara juridike, duke ngritur pikëpyetje serioze mbi pajtueshmërinë e saj me Kushtetutën shqiptare, të drejtën ndërkombëtare dhe legjislacionin e Bashkimit Europian. Megjithëse Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë nuk e bllokoj ratifikimin, ajo theksoi mungesën e garancive mbrojtëse për të drejtat e migrantëve. Ndërkohë, vendimet e Gjykatës së Apelit në Romë dhe pezullimi nga Gjykata e Kasacionit nënvizojnë shqetësime mbi mungesën e garancive procedurale, statusin e vendeve të sigurta të origjinës dhe respektimin e të drejtave të azilkërkuesve në përputhje me direktivat e BE-së për kthimin dhe azilin. Referimet në Gjykatën e Drejtësisë së BE-së theksojnë nevojën për një vlerësim të harmonizuar të standardeve të mbrojtjes dhe transparencës në procedurat ndërkufitare, duke e vendosur marrëveshjen nën shqyrtim të thelluar juridik dhe politik në nivel europian.

Marrëveshja për transferimin e procedurave të azilit në një vend të tretë nxit shqetësime të thella lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, veçanërisht për grupet vulnerabël. Mungesa e garancive të qarta procedurale, e qasjes në ndihmë juridike dhe e mekanizmave të vlerësimit të cenueshmërisë krijon një terren të pasigurt ligjor që mund të çojë në shkelje të të drejtave themelore, duke përfshirë parimin e moskthimit dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Rreziqet për trafikim, shfrytëzim dhe trajtim të papërshtatshëm janë veçanërisht të theksuara në mungesë të mekanizmave efektive të mbikëqyrjes dhe ndarjes së përgjegjësi

ndërmjet shteteve. Në këtë kuadër, marrëveshja përfaqëson një sfidë serioze për standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të drejtës së refugjatëve, duke rrezikuar të kthehet në një praktikë që minon mbrojtjen ndërkombëtare në vend që ta forcojë atë.

Modeli i eksternalizimit të procedurave të azilit i parashikuar nga kjo marrëveshje përbën një devijim të dukshëm nga parimet bazë të sistemit të përbashkët europian të azilit. Transferimi i azilkërkuesve në territorin shqiptar, nën juridiksion italian por jashtë kufijve të BE-së, krijon një hapësirë gjeo-juridike të paqartë që sfidon standardet ekzistuese të mbrojtjes dhe minon garancitë për procedura të drejta dhe akses efektiv në mjete juridike. Ky model i "juridiksionit të zgjeruar" rrezikon të fragmentarizojë sistemin europian të mbrojtjes së refugjatëve dhe ngrë shqetësime serioze mbi respektimin e Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së dhe Direktivës për Procedurat e Azilit.

Marrëveshja italo-shqiptare për menaxhimin e migracionit të parregullt përfaqëson një precedent kompleks juridik dhe etik, duke artikuluar një tension të thellë ndërmjet paradigmes së sigurisë dhe kontrollit të migracionit dhe angazhimeve ndërkombëtare për garantimin e të drejtave themelore të njeriut, veçanërisht për grupet në situatë vulnerabiliteti. Prandaj, çdo marrëveshje ndërqeveritare për menaxhimin e migracionit duhet të ndërtohet mbi parimin e primatit të të drejtave të njeriut, duke siguruar mbrojtje të vazhdueshme, efektive dhe jo-diskriminuese gjatë gjithë ciklit migrator, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe detyrimet që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare e refugjatëve dhe të drejtatënjeriut.

[1] International Organization for Migration (IOM). (2023). IOM Albania Infosheet. Marrë nga: <https://albania.iom.int/sites/g/files/tmzbd1401/files/documents/2023-03/IOM%20Albania%20Infosheet.pdf>

[2] Chaloff, J. (2008). Albania and Italy: Migration policies and their development relevance (Working Paper No. 51). Centro Studi di Politica Internazionale (CeSPI). Faqe 5-7. Marrë nga: https://www.cespi.it/sites/default/files/documenti/wp_51-albania_and_italy-chaloff.pdf

[3] Camera dei Deputati. (2023). Disegno di legge n. 1620: Ratifica ed esecuzione del Protocollo tra il Governo della Repubblica italiana e il Consiglio dei ministri della Repubblica di Albania per il rafforzamento della collaborazione in materia migratoria, fatto a Roma il 6 novembre 2023, nonché norme di coordinamento con l'ordinamento interno. Marrë nga: <https://documenti.camera.it/leg19/pdl/pdf/leg.19.pdl.camera.1620.19PDL0068550.pdf>

[4] Treaty of friendship and cooperation between the Italian Republic and the Republic of Albania, with exchange of letters clarifying Article 19, ratified by Law No. 170/1998. Marrë nga: <https://www.parlamento.it/parlam/leggi/98170l.html>

[5] Qeveria Shqiptare, Këshilli i Ministrave. (2023). Protokoll ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit. Marrë nga <https://www.kryeministria.al/newsroom/protokoll-ndermjet-qeverise-se-republikes-italiane-dhe-keshillit-te-ministrave-te-republikes-se-shqiperise-per-forcimin-e-bashkepunimit-ne-fushen-e-migracionit/>

[6] Council of the European Union. (2015). Council Decision (EU) 2015/1601 of 22 September 2015 establishing provisional measures in the area of international protection for the benefit of Italy and Greece. Official Journal of the European Union, L 248, 80–94. Marrë nga: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:32015D1601>

[7] Council of the European Union. (2017). Malta Declaration by the members of the European Council on the external aspects of migration: addressing the Central Mediterranean route. Marrë nga: <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2017/02/03/malta-declaration/>

[8] Ministero del Lavoro e delle Politiche Sociali. (2025). Nel CPR in Albania anche gli espulsi dall'Italia. Integrazione Migranti – Portale di informazione sull'integrazione dei migranti in Italia. Marrë nga: <https://integrazionemigranti.gov.it/it-it/Ricerca-news/Dettaglio-news/id/4213/Nel-CPR-in-Albania-anche-gli-espulsi-dallItalia>

[9] Pettrachin, A., & Bassoli, M. (2025). The Italy-Albania migration deal – a policy failure? EUROPP – European Politics and Policy. London School of Economics and Political Science. Marrë nga: <https://blogs.lse.ac.uk/europpblog/2025/02/07/the-italy-albania-migration-deal-a-policy-failure/>

[10] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. (2024). Njoftim për shtyp: Shqyrtimi i kërkesës për Protokollin Shqipëri-Itali. Marrë nga https://www.gjk.gov.al/web/Njoftim_per_shtyp_30251-94.php

[11] Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë. (2024). Vendim nr.2 (V-2/24): Deklarimi i papajtueshëm me Kushtetutën i Protokollit ndërmjet Qeverisë së Republikës Italiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë “Për forcimin e bashkëpunimit në fushën e migracionit”. Marrë nga: https://www.gjk.gov.al/include_php/previewdoc.php?id_kerkesa_vendimi=3990&nr_vendim=1

[12] Tarabusi, C. (2024). Il Protocollo Italia-Albania al vaglio giurisdizionale: dal Tribunale di Roma alla Corte di Giustizia UE. Fondazione ISMU. Marrë nga: <https://www.ismu.org/il-protocollo-italia-albania-al-vaglio-giurisdizionale-dal-tribunale-di-roma-alla-corte-di-giustizia-ue/>

[13] Tribunale Ordinario di Roma, Sezione per i diritti della persona e immigrazione. (2024). Comunicato stampa sui trattenimenti disposti ai sensi del Protocollo Italia-Albania. *Questioni Giustizia*. Marrë nga: <https://www.questionegiustizia.it/data/doc/3971/comunicato-stampa.pdf>

[14] Court of Justice of the European Union. (2024) Judgment of the Court (Grand Chamber) in Case C-406/22 (ECLI:EU:C:2024:841). Marrë nga: https://www.stradalex.eu/en/se_src_publ_jur_eur_c_ju_st/document/cjeu2024_C_406_22_57

[15] Corte d'Appello di Roma. (2025). Ordinance No. 478/2025: Preliminary ruling to the Court of Justice of the European Union and suspension of the detention validation procedure at the return center in Gjader, Albania. Marrë nga: <https://www.piuculture.it/wp-content/uploads/2025/01/Corte-dAppello-di-Roma-n.478-25.pdf>

[16] Tribunale di Roma. (2024). Ordinanza di rinvio pregiudiziale relativa alla designazione della "lista dei paesi sicuri" nell'ambito dell'accordo Italia-Albania. Marrë nga: https://eurojusitalia.eu/epdf/1731941878_Ordinanza%20rinvio%20pregiudiziale%20Trib.%20Roma%2011.11.2024.pdf

[17] UNHCR. (2023). Transfer arrangements for asylum-seekers and refugees must respect international law and refugee protection standards. Marrë nga: <https://www.unhcr.org/news/press-releases/unhcr-transfer-arrangements-asylum-seekers-and-refugees-must-respect>

[18] Carrera, S., Campesi, G., & Colombi, D. (2023). The 2023 Italy-Albania protocol on extraterritorial migration management: A worst practice in migration and asylum policies (Papers on Liberty and Security in Europe). CEPS. Faqe 2, 5-7, 17-18. Marrë nga: https://cdn.ceps.eu/wp-content/uploads/2023/12/ASILE_Italy-Albania-MoU-Extraterritorial-Migration-Management.pdf

[19] De Leo, A., & Celoria, E. (2025). The Italy-Albania Protocol: A new model of border-shifting within the EU and its compatibility with Union law. *Maastricht Journal of European and Comparative Law*, 31(5), 595-618. Faqe 602-603. Marrë nga: <https://doi.org/10.1177/1023263X241309601https://journals.sagepub.com/doi/pdf/10.1177/1023263X241309601>

[20] De Leo, A. (2023). On the incompatibility of the Italy-Albania protocol with EU asylum law. *SIDI Blog*. Marrë nga: <https://www.sidiblog.org/2023/11/15/on-the-incompatibility-of-the-italy-albania-protocol-with-eu-asylum-law/>

[21] Amnesty International. (2024). The Italy-Albania Agreement on Migration: Pushing Boundaries of Asylum Law and Human Rights Protections (EUR30/7587/2024). Faqe 6-7, 10-11. Marrë nga: <https://www.amnesty.org/en/documents/EUR30/7587/2024/en/>

[22] European Commission. (2024). Albania 2024 Report: Commission Staff Working Document Accompanying the 2024 Communication on EU Enlargement Policy. Faqe 47. Marrë nga: https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania+Report+2024.pdf

[23] Varvelli, A., & Ziccardi, A. (2025). Why the EU should pay attention to Italy's and Albania's migration gamble. *European Council on Foreign Relations*. Marrë nga: <https://ecfr.eu/article/why-the-eu-should-pay-attention-to-italy-and-albanias-migration-gamble/>

[24] European Parliament. (2024). Compliance of the Italy-Albania protocol with EU law | P-002206/2024. Marrë nga: https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/P-10-2024-002206_EN.html

[25] Amnesty International. (2024). The Italy-Albania Agreement on Migration: Pushing Boundaries of Asylum Law and Human Rights Protections

(EUR30/7587/2024).

<https://www.amnesty.org/en/documents/EUR30/7587/2024/en/>

[26] Amnesty International. (2017). The human rights risks of external migration policies. Marrë nga: <https://www.amnesty.org/en/documents/pol30/6200/2017/en/>

[27] Broerse, I. (2024). The Italy-Albania Agreement: Externalising asylum procedures in violation of human rights (ACMRL Migration Law Series No. 26). Amsterdam Centre for Migration and Refugee Law. <https://doi.org/10.71881/51abe5cb-92a2-4de9-8395-9323bdc7f75c>

[28] De Leo, A. (2023, November 15). On the incompatibility of the Italy-Albania protocol with EU asylum law. SIDI Blog. <https://www.sidiblog.org/2023/11/15/on-the-incompatibility-of-the-italy-albania-protocol-with-eu-asylum-law/>

[29] Amnesty International. (2024). The Italy-Albania Agreement on Migration: Pushing Boundaries of Asylum Law and Human Rights Protections (EUR30/7587/2024). Marrë nga: <https://www.amnesty.org/en/documents/EUR30/7587/2024/en/>

[30] Varvelli, A., & Ziccardi, A. (2025). Why the EU should pay attention to Italy's and Albania's migration gamble. European Council on Foreign Relations. Marrë nga: <https://ecfr.eu/article/why-the-eu-should-pay-attention-to-italy-and-albanias-migration-gamble/>

[31] De Leo, A., & Celoria, E. (2025). The Italy-Albania Protocol: A new model of border-shifting within the EU and its compatibility with Union law. *Maastricht Journal of European and Comparative Law*, 31(5), 595-618. Faqe 602-603. Marrë nga: <https://journals.sagepub.com/doi/pdf/10.1177/1023263X241309601>

[32] Council of Europe Commissioner for Human Rights. (2024). Italy-Albania agreement adds to worrying European trend towards externalising asylum procedures. Council of Europe. Marrë nga: <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/italy-albania-agreement-adds-to-worrying-european-trend-towards-externalising-asylum-procedures>

[33] UNHCR. (2023). Transfer arrangements for asylum-seekers and refugees must respect international law and refugee protection standards. Marrë nga: <https://www.unhcr.org/news/press-releases/unhcr-transfer-arrangements-asylum-seekers-and-refugees-must-respect>

[34] Giordani, C. (2024). The Italy-Albania Agreement on Migration: From the Fiction of Non-Entry to Functional Entry (Policy Brief No. 191/2024). Hellenic Foundation for European & Foreign Policy (ELIAMEP). Faqe 3, 12. Marrë nga: <https://www.eliamep.gr/wp-content/uploads/2024/06/Policy-brief-191-Italy-Albania-EN-final-1.pdf>